

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6716
E martë, 27 shtator 2022
çmimi 0.40 €

BE-ja "e shqetësuar" për forcimin e bashkëpunimit Serbi - Rusi

FAQE 50



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN, NË REND DITE NË BE MË 13 TETOR

FAQE 4-5



Çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë në rend të ditës në takimin e grupit punues të Këshillit Evropian më 13 tetor, konfirmojnë burimet diplomatike të BE-së në Bruksel. Presidenca çeke e BE-së tashmë u ka dërguar letër vendeve anëtare si paralajmërim për diskutimet

për këtë temë. Në këtë letër Çekia thirret edhe në, siç thuhet, arsyet e politikës së jashtme për liberalizimin e vizave për Kosovën, duke rikujtuar se edhe Komisioni Evropian ka konfirmuar dhe pritet të përsërisë se Kosova i ka përmbushur kushtet

AKTUALE



**DISA MËSIMDHËNËS NISIN MËSIMIN,
TË TJERËT NË GREVË** F. 2

**POZITË E OPOZITË PËRKUJTOJNË
24-VJETORIN E MASAKRËS NË ABRI
TË EPËRME** F. 6

**FSK-ja REALIZON MARSHIMIN
DYDITOR NË RAJONIN E GJAKOVËS,
E GATSHME PËR MISIONIN E SAJ** F. 3

**ZYRTARËT E PDK-së VIZITOJNË
LIDERËT E UÇK-SË NË HAGË:
ATA PO MBAHEN PENGË** F. 5

EKONOMI



KEK-u NDAL BLOKUN A3 F. 8

**ODAT AMERIKANE TË RAJONIT
PAJTOHEN PËR FUQIZIM
TË BASHKËPUNIMIT** F. 8

SPORT



**REKRUTOHEN 61 GJYQARË TË RINJ,
AVANCOHEN 73 TË TJERË** F. 10

Reagim i KMDLNj-së



**VIZITA MASHTRUESE
E MASHTRUESES
EKATERINA
TRANDAFILOVA
NË KOSOVË!** I FAQE 3



**KURTI RIZGJEDHET KRYETAR I LV-së,
HAXHIU KRYETARE E GRUAS** I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Disa mësimdhënës nisin mësimin, të tjerët në grevë

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Në Kosovë është duke u rritur numri i shkollave dhe mësimdhënësve që kanë ndërprerë grevën në institucionet arsimore e cila ka hyrë në javën e pestë. Si pasojë e grevave që kanë nisur në sektorin e arsimit më 25 gusht, mbi 300 000 nxënës kanë mbetur pa mësim.

Këshilli i Arsimitarëve dhe Këshilli Grevist i Shkollës Fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë kanë njoftuar të hënën se më 27 shtator do të fillojë procesi mësimor me orar të reduktuar të orëve mësimore nga 45 në 30 minuta.

Javë më parë grevën e kanë ndërprerë edhe disa shkolla dhe mësimdhënës në Gjakovë, Prishtinë, Fushë-Kosovë e disa qytete të tjera të Kosovës.

Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve drejtuar Qeverisë së Kosovës është ndarja e 100 eurove në muaj për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga.



Qeveria e Kosovës thotë se Ligji për Paga, që parasheh rritjen e tyre, do të dalë në miratim së shpejti. Para disa javësh ajo ka paraqitur një pako për përbalje me inflacionin, në kuadër të së

cilës punonjësit e sektorit publik përfitojnë nga 50 euro shtesë nisur nga ky muaj.

Por, me këtë shumë nuk janë pajtuar sindikalistët e arsimit. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar

të Arsimit të Kosovës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka thënë të hënën për "Radion Evropa e Lirë" se mund të ketë ide të ndryshme për mënyrën e grevës, por qëndrimi i Këshillit Grevist është

që greva të jetë e plotë. Sipas tij, idetë që greva të mbahet duke mbajtur procesin mësimor me orar të shkurtuar nuk vjen nga organet drejtuese të SBASHK-ut. "Kemi një grevë unike, 98.5 për qind e institucioneve arsimore janë në grevë. Uroj që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe të tjerët të ulen dhe të bisedojnë me Këshillat Grevist dhe të bëhet një zgjidhje", ka thënë ai.

Të hënën prindërit e nxënësve të Shkollës Fillore "Faik Konica" në Prishtinë kanë mbajtur një protestë duke kërkuar nga mësimdhënësit hapjen e shkollave për fëmijët.

Jasharaj beson se mundësitë për të dalë nga kjo situatë janë të lehta.

Ai kërkon nga qeveria që të negociojë me Këshillin Grevist dhe të sjellë një ofertë të re. Përveç mësimdhënësve, në grevë janë edhe punëtorët e administratës publike si dhe shërbyesit civilë në institucione lokale dhe qendrore.

Shkupi nuk njeh referendimet e rreme ruse në Ukrainë

SHKUP, 26 SHTATOR - Maqedonia e Veriut nuk njeh rezultatet e të ashtuquajturave referendime në rajonet e Ukrainës, tha më 26 shtator ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani.

"Referendimet në territoret e okupuara të Ukrainës janë manipuluese dhe Republika e Maqedonisë së Veriut nuk do t'i njohë rezultatet. Duhet të punohet për t'u shpjeguar qytetarëve tanë dëmet e agresionit rus kundër Ukrainës dhe çfarë kjo do të thotë për interesat tona kombëtare", tha Osmani, duke shtuar se të jesh në anën e agresionit rus do të thotë të jesh kundër interesave të tua kombëtare. "Ne si politikanë dhe mediet duhet të shpjegojmë se çfarë do të thotë kjo dhe çfarë lloj efekti domino prodhon kur një vend më i fortë dëshiron ta aneksojë territorin e një vendi fqinj", shtoi ai.

Në katër rajone të Ukrainës, që pjesërisht kontrollohen nga Rusia, po mbahen referendimet e rreme ruse, që kanë nisur më 23 shtator dhe do të vazhdojnë deri më 27 shtator. "Qëndrimi yni si shteti është i qartë është se këto janë referendime manipuluese, qëllimi i të cilave është alibia për aneksimin e territoreve të vendeve të tjera dhe ne nuk do t'i njohim rezultatet e referendimeve të tilla", theksoi Osmani.

Lidhur me marrëdhëniet me Rusinë dhe kontaktet me Ambasadën ruse, Osmani tha se nuk ka asnjë raport me Moskën.

Maqedonia e Veriut, sipas tij, mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe që në fillim të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës ka mbështetur të gjitha sanksionet që janë vendosur kundër Rusisë.



OECD: Lufta në Ukrainë, me ndikim më të madh në ekonominë botërore



KIEV, 26 SHTATOR - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ka njoftuar se lufta e Rusisë në Ukrainë që tani ka hyrë në muajin e tetë do të ketë ndikim më të madh në ekonominë botërore seç ishte parashikuar.

OECD-ja më 26 shtator uli parashikimin e rritjes globale në 2.2 për qind për vitin 2023, nga 2.8 për qind, siç kishte parashikuar më herët. "Ekonomia botërore po paguan

çmim të lartë për luftën e paprovokuar dhe joligjore të Rusisë ndaj Ukrainës", ka njoftuar OECD në raportin e rregullt për parashikimet për ekonominë botërore. "Me ndikimin e pandemisë Covid-19 që ende ka efekt, lufta po pengon rritjen dhe po shton presion ndaj çmimeve, veçmas atyre të ushqimit dhe energjisë. Bruto Prodhimi i Brendshëm në nivel botëror ka stagnuar në çerekun e dytë të vitit 2022 dhe

është regjistruar rënie në ekonominë e G20-s", u shtua në raport.

Në raport u tha se inflacioni i lartë po vazhdon më shumë sesa pritej. Niveli i inflacionit në gjysmën e parë të vitit 2022 ishte më i lartë që nga vitet '80. "Me treguesit e fundit, që janë përkeqësuar, perspektiva e ekonomisë globale është errësuar", ka njoftuar OECD. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.



Osmani: Kontributi i mërgatës në Amerikë ishte vendimtar dikur, është përcaktues edhe sot

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Presidentja e Kosovës ka takuar në Nju-Jork shumë bashkatdhetarë të cilët, sipas saj, ndër vite i kanë dhënë hov dhe mbështetje të jashtëzakonshme luftës sonë për liri. "Në emër të të gjithë qytetarëve dhe institucioneve

të Kosovës i falënderova për kontributin e dhënë ndër dekada dhe pa të cilin nuk do të ishim këtu ku jemi sot. Kosova aspirojnë integrimin euroatlantik, BE-në, NATO-n dhe OKB-në, ndaj kontributi i mërgatës sonë në Amerikë dhe gjithandej siç ishte

vendimtar dikur, është përcaktues edhe sot", ka thënë Osmani.

Presidentja ka shtuar se me mbështetjen e mërgatës sonë të çmuar Kosova do të jetë më e fuqishme përbrenda e më e konsoliduar në aspektin ndërkombëtar.

Kurti rizgjedhet kryetar i LV-së, Haxhiu kryetare e gruas

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 26 shtator - Lëvizja Vetëvendosje ka përfunduar procesin e brendshëm zgjedhor. Kryetar i saj edhe për një mandat të ri është zgjedhur Albin Kurti, i cili ka marrë 98.60 për qind të votave të anëtarësisë.

Ndërkaq Albulena Haxhiu është zgjedhur kryetare e Gruas në Vetëvendosje me 94.55 për qind të votave. Kryetar i Rinisë në LV është zgjedhur Behar Jashari me 85.55 për qind të votave.

Zgjedhjet në LV u organizuan në mbi 200 vendvotime.

Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se procesi do të vazhdojë me zgjedhjen e kryesive të qendrave e do të përfundojë në fund të muajit tetor me zgjedhjen e kryesive të LV-së në mbledhjen konstituive të Këshillit të Përgjithshëm. "Në këtë proces të gjatë janë strukturuar gjithsej 485 pika në 29 qendra të Lëvizjes Vetëvendosje. Komisioni Zgjedhor i Përgjithshëm konstaton se procesi ka kaluar në mënyrë të rregullt si rezultat i një pune të madhe që është bërë gjithandej nëpër qendrat e Lëvizjes", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje. Komisioni Zgjedhor i Përgjithshëm



në këtë subjekt politik i ka falënderuar të gjithë aktivistët e përfshirë në menaxhimin dhe administrimin e zgjedhjeve të brendshme. "Falënderojmë të gjithë anëtarët që kanë shprehur sot të lirë vullnetin e tyre mbi të ardhmen e organizatës. I jemi mirënjohës stafit të Komisionit Qendror Zgjedhor të Republikës së Kosovës dhe të Komisioneve Komunale Zgjedhore për asistencën dhe materialet e votimit të vëna në dispozicion anekënd Kosovës për zhvillimin e procesit të zgjedhjeve të brendshme të Lëvizjes

Vetëvendosje", ka njoftuar ky subjekt politik.

Albulena Haxhiu ka shkruar në "Facebook" se rritja e madhe e LV-së kërkon edhe më shumë punë dhe përgjegjësi për të shërbyer veçmas në aspiratat që ka ndërtuar e për të cilat nuk do të rreshtin së angazhuari asnjëherë. "Si Lëvizje progresiste dhe emancipuese, me ritëm të shtuar do të lëvizim, me gra dhe burra, duke krijuar një realitet të ri të barazisë jo vetëm përbrenda organizatës, por të etabluar gjithandej shoqërisë. Pjesëmarrja aktive e anëtarësisë në Lëvizje,



vullneti i tyre i shprehur edhe me votë, mandatoi drejtuesit e zgjedhur për të rrugëtuar edhe më fuqishëm drejt orientimit të qartë, të drejtë e të duhur. Zgjedhja ime nga vota juaj, si kryetare e Gruas në Vetëvendosje, si bartëse e kauzës për gratë, të drejtat dhe liritë e saj, është përgjegjësi dhe nder për të cilën jam e bindur se do të shënojme arritje të reja", ka thënë ajo.

Haxhiu ka theksuar se me gratë e qyteteve e fshatrave, me profesione nga më të ndryshmet, me vullnetin e tyre për vetëvendosje, do të jenë kudo dhe gjithandej duke i kontribuar edhe më shumë

shoqërisë, lirisë e demokracisë.

Ndërkaq Arben Vitia është zgjedhur kryetar i LV-së për Prishtinë. Në mesazhin e tij pas zgjedhjes, ai ka theksuar se kanë para vetes sfida dhe mundësi. "Së bashku do t'i jetësojmë si aspiratë progresiste, si demokraci, si vlera socialdemokrate dhe si organizim gjithëpërfshirës shoqëror. Duke ju falënderuar për kontributin e dhënë, ndihmën e paçmuar në çdo hap dhe për besimin që më dhatë në drejtimin e Qendrës së Prishtinës, ju ftoj që të përpiqemi së bashku për më mirë, për më shumë", ka thënë Vitia.

FSK-ja realizon marshimin dyditor në rajonin e Gjakovës, e gatshme për misionin e saj



PRISHTINË, 26 SHTATOR - Regjimenti i Xhenios i Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka realizuar marshimin dyditor me aktivitete të ndryshme me

qëllim të testimit të kapaciteteve të qëndrueshmërisë. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se shtigjet e lirisë frymëzojnë ushtarakët

tanë për forcë e qëndrueshmëri maksimale në realizimin e misionit. "Gjatë marshimit me distancë 30 km dhe lartësi mbidetare deri në 2281m në rajonin e Gjakovës, pjesëtarët,

përveç sfidave të terrenit malor, u ndalën për të bërë homazhe pranë memorialëve të dëshmorëve dhe u njohën për së afërmi me shtigjet e furnizimit logjistik të UÇK-së", ka thënë ai.

Ministri Mehaj ka theksuar se aktivitetet e tilla testojnë përgatitjen fizike dhe ushtarake të pjesëtarëve të FSK-së për të qenë të gatshëm për kryerjen e detyrave në bazë të misionit.



Liberalizimi i vizave për Kosovën, në rend dite në BE më 13 tetor

Çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë në rend të ditës në takimin e grupit punues të Këshillit Evropian më 13 tetor, konfirmojnë burimet diplomatike të BE-së në Bruksel. Presidenca çeke e BE-së tashmë u ka dërguar letër vendeve anëtare si paralajmërim për diskutimet për këtë temë. Në këtë letër Çekia thirret edhe në, siç thuhet, arsyet e politikës së jashtme për liberalizimin e vizave për Kosovën, duke rikujtuar se edhe Komisioni Evropian ka konfirmuar dhe pritet të përsërisë se Kosova i ka përmbushur kushtet

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë në rend të ditës në takimin e grupit punues të Këshillit Evropian më 13 tetor, konfirmojnë burimet diplomatike të BE-së në Bruksel.

Presidenca çeke e BE-së tashmë u ka dërguar letër vendeve anëtare si paralajmërim për diskutimet për këtë temë. "Radio Evropa e Lirë" ka siguruar qasjen në këtë dokument dhe aty shprehet qartë dëshira e Çekisë që të gjitha vendet anëtare të BE-së të arrijnë konsensus të brendshëm për ta mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën.

Në këtë letër Çekia thirret edhe në, siç thuhet, arsyet e politikës së jashtme për liberalizimin e vizave për Kosovën, duke rikujtuar se edhe Komisioni Evropian ka konfirmuar dhe pritet të përsërisë se Kosova i ka përmbushur kushtet. "Pasi Presidenca Çeke mendon se arsyet e lidhura me politikën e jashtme për liberalizimin e vizave për Kosovën janë bindëse. Ajo shpreson se të gjitha shtetet anëtare të BE-së do të arrijnë pajtim të brendshëm

politik për këtë çështje", thuhet në këtë dokument. "Qasja gjeopolitike e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor është e domosdoshme. Rajoni ka nevojë për sinjal të qartë se procesi i zgjerimit të BE-së është i zgjerimit dhe se BE-ja është e gatshme t'i shpërblejë përpjekjet për reforma që bëjnë vendet e Ballkanit Perëndimor", thuhet në këtë letër.

Presidenca çeke përmend aty pikërisht liberalizimin e vizave për Kosovën si shembull se si BE-ja mund të rrisë besueshmërinë në rajon. "Liberalizimi i vizave është element kyç në procesin e integrimi të Kosovës në BE, që është shumë i vonuar tashmë. Kosova është i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor (dhe një prej pak vendeve në Evropë) që akoma nuk e ka siguruar regjimin pa viza me BE-në. Ky fakt ka një ndikim të konsiderueshëm negativ në atmosferën në vend dhe në qëndrimet e qytetarëve të Kosovës rreth korrektësisë dhe kredibilitetit të BE-së", thuhet në letër.

Aty, po ashtu, rikujtohet rrugëtimi

i Kosovës drejt përmbushjes së kushteve për lëvizjen e lirë të qytetarëve të saj. "Komisioni Evropian ka nisur dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën në vitin 2012, ndërsa në korrik të vitit 2018 ka konfirmuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret. Parlamenti Evropian, në vazhdimësi, ka konfirmuar se mbështet liberalizimin e vizave për Kosovën", thuhet në letër. Presidenca çeke e BE-së thekson se pret që Komisioni Evropian të konfirmojë mendimin pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën. "Presidenca Çeke është në kontakt të ngushtë me Komisionin Evropian. Jemi pajtuar për një përditësim teknik të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave që do të mbulonte periudhën nga raporti i publikuar në vitin 2018. Ky përditësim teknik supozohet se do t'i paraqitet grupit punues për vizat në muajin tetor", thuhet po ashtu letër.

Sipas saj, Presidenca çeke beson se ky përditësim do të jetë pozitiv dhe se do t'i konfirmojë rezultatet e gjetjeve të Komisionit në vitin 2018. "Ambicje e Presidencës çeke

është që të ndërtojë mbështetje mes shteteve anëtare dhe të nisë procedurën relevante legjislative, që do të rezultojë me relaksim të regjimit të vizave për Kosovën", thuhet në letër.

Përmes saj, Çekia thotë se i kupton edhe shqetësimet e disa vendeve anëtare të BE-së për implikimet që mund t'i ketë liberalizimi i vizave për Kosovën për sigurinë e brendshme të tyre. Për këtë arsye, ministrinë e Punëve të Brendshme të vendeve anëtare janë më shumë të rezervuara për të miratuar liberalizimin e vizave, sesa ministrinë e Punëve të Jashtme.

Çekia, megjithatë, thirret në vlerësimin e Komisionit Evropian për adresimin e këtyre shqetësimeve.

"Komisioni Evropian është i bindur se dhënia e liberalizimit të vizave për Kosovën nuk paraqet rrezik për vendet anëtare në formën e valës së imigrimit", thotë Presidenca çeke, duke shtuar se edhe Kosova ka marrë masa për t'i adresuar këto shqetësime. "Vlen të theksohet se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar më 3 gusht rezolutën për liberalizimin e vizave. Me këtë rezolutë, institucionet e Kosovës zotohen t'i zbatojnë të gjitha reformat, për të garantuar sundimin e ligjit, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Presidenca çeke vlerëson lart miratimin e kësaj rezolute, e cila është një dëshmi e rëndësishme e

përkushtimit nga ana e Kosovës", thuhet në letër.

Diskutimi i parë në grupin punues të Këshillit për liberalizimin e vizave për Kosovën pritet të zhvillohet vetëm një ditë pasi Komisioni Evropian ta miratojë dhe publikojë paketën vjetore të zgjerimit, e cila do të shoqërohet edhe me raportet individuale të progresit për vendet e përfshira në këtë proces.

Edhe nga Komisioni Evropian është konfirmuar se do të raportojë pozitivisht për përmbushjen e kriterëve nga ana e Kosovës sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave.

Burimet diplomatike në Bruksel e shohin qëllimin e Çekisë që të nisë procedurën për vendimin për liberalizimin e vizave si dëshmi se tashmë ekziston një mbështetje e madhe për këtë në Këshill. Por, përkundër kësaj, ato hezitojnë të përmendin afate se kur do të miratohej vendimi dhe kur do të hynte në fuqi liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës.

Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që mbeten jashtë BE-së, vetëm qytetarët e Kosovës nuk mund të lëvizin lirshëm në vendet evropiane, apo në atë që njihet si zona Shengen.

Kosova, ashtu si edhe Bosnjë-Hercegovina, ka vetëm Marrëveshje Stabilizimi me BE-në, që është hapi i parë drejt anëtarësimit në bllok.

Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, ndërkaq, i kanë hapur negociatat për anëtarësim në BE.

BE-ja “e shqetësuar” për forcimin e bashkëpunimit Serbi - Rusi



Bruksel, 26 shtator - Bashkimi Evropian ka shprehur shqetësimin për forcimin e raporteve midis Serbisë dhe Rusisë, pasi këto dy shtete nënshkruan një marrëveshje për bashkëpunim në sferën e politikës së jashtme.

Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Peter Stano, tha se kjo marrëveshje erdhi në kohën kur Rusia po vazhdon agresionin ndaj Ukrainës dhe çdo ditë “po e shkel të drejtën ndërkombëtare, forcat e saj po kryejnë krime ndaj civilëve e në pjesë të okupuara [të Ukrainës] po organizon referendume ilegale”. “Nëse në këto rrethana shohim se ministri i Jashtëm i Serbisë nënshkruan marrëveshje, me të cilën pajtohet për konsultime me shtetin që kryen akte të tilla, atëherë kjo është shenjë se Serbia po i forcon raportet me Rusinë. Dhe kjo ngreh shqetësime serioze. Raportet me Rusinë në këtë nuk mund të jenë sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Këto ne i marrim shumë seriozisht”, tha Stano. Sipas tij, Serbia ka deklaruar se qëllim strategjik ka integrimin në bllokun evropian. Andaj, sipas Stanos, edhe “ky vendim i Serbisë do të duhej të nënkuptonte edhe bashkëpunimin dhe përafrimin me BE-në në çështje të politikës së jashtme”. “BE-ja ka qenë krejtësisht e qartë me të gjitha vendet anëtare dhe partnerët, përfshirë edhe vendin kandidat, Serbinë: raportet me Rusinë nuk mund të jenë punë e zakonshme nën hijen e pushtimit të paprovokuar dhe të paarsyeshëm në Ukrainë”, tha Stano.

Stano ftoi udhëheqjen në Serbi që të sigurojë, si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, “një koherencë më të fuqishme mes nismave të saj në politikën e jashtme dhe mbështetjen për vlerat ndërkombëtare dhe pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht”.

Serbia është kritikuar për afrimin e saj me Federatën Ruse edhe nga deputetët e tjerë të Parlamentit Evropian.

Në mesin e tyre edhe Vladimir Bilçik, raportues për Serbinë në PE dhe Viola von Cramon, raportuese

për Kosovën. Kjo e fundit madje ka përmendur edhe mundësinë e pezullimit të negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE. Bilçik shkroi në “Twitter” se lajmin për nënshkrimin e marrëveshjes e sheh si një goditje të madhe për procesin e zgjerimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor. Ndërkaq, von Cramon tha se “anëtarësimi në BE nuk kalon përmes Moskës”.

Çfarë përmban marrëveshja e nënshkruar midis Serbisë dhe Rusisë?

Më 23 shtator ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, dhe ai i Serbisë, Nikolla Sellakoviç, nënshkruan Planin e Konsultimeve të dy ministereve për dy vjetët e ardhshme.

Sellakoviç është në krye të diplomacisë serbe, në qeverinë teknike, teksa Serbia pritet të formojë një qeveri të re të dalë nga zgjedhjet e prillit.

Dokumenti u nënshkrua në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. I pyetur nga gazetaret se çfarë përfshin plani dhe çfarë mesazhi i dërgon BE-së, Sellakoviç tha më 25 shtator se “ata që nuk e kanë parë dokumentin, po e sulmojnë të njëjtën”. “Gjithçka që ka të bëjë me kritikën dhe çështjet lidhur me këtë plan janë kërkim i arsyeve për ta sulmuar Serbinë dhe për ta qortuar”, tha ai.

Sellakoviç deklaroi se Plani i Konsultimeve me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Rusisë “është nënshkruar që nga viti 1996, çdo dy vjet”, duke theksuar se bëhet fjalë për “çështje teknike siç janë marrëdhëniet dypalëshe dhe aktivitetet shumëpalëshe”.

Ky është dokumenti i parë diplomatik që Serbia dhe Rusia kanë nënshkruar që nga 24 shkurti kur nisi pushtimi rus në Ukrainë.

Për shkak të agresionit të saj kundër Ukrainës, Rusia është subjekt i sanksioneve nga BE-ja, Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera perëndimore.

Serbia ka votuar disa rezoluta të OKB-së që dënojnë pushtimin rus të Ukrainës. Megjithatë, Beogradi, edhe pse është kandidat për

anëtarësim në BE, refuzon ta harmonizojë politikën e tij me atë të bllokut dhe të vendosë sanksione ndaj Rusisë.

Hill kërkon shpjegime nga Serbia për marrëveshjen me Rusinë

Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, tha se pret shpjegime nga Serbia se çfarë përmban dokumenti i bashkëpunimit që ka nënshkruar me Rusinë gjatë punimeve të Kombeve të Bashkuara javën e kaluar. Në një konferencë për medie në hapjen e një forumi rajonal për qeverisje të mirë, Hill tha se “nuk është plotësisht e qartë” se çfarë përmban dokumenti, por se “në këtë moment askush nuk do të duhej të nënshkruante diçka me Rusinë”.

“Edhe ashtu askush nuk është duke nënshkruar diçka me

Rusinë. E kemi të vështirë ta kuptojmë, por presim shpjegim”, tha Hill.

Ai shtoi se ShBA-ja e mbështet Serbinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe, po ashtu, mbështet heqjen dorë nga varësia e saj energjetike ndaj Rusisë “që bazohet në shantazh”, por kjo ndihmë do të jetë aq sa kërkon Serbia. Ambasadori amerikan tha se ShBA-ja do që të dëgjojë se çfarë dëshiron Serbia me nënshkrimin e një marrëveshjeje me një shtet që “brutalisht sulmoi fqinjin e tij” dhe po kërcënon që të përdorë armë bërthamore.



Zyrtarët e PDK-së vizitojnë liderët e UÇK-së në Hagë: Ata po mbahen pengë

HAGË, 26 SHTATOR - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, shefi i grupit parlamentar, Abelard Tahiri dhe anëtari i kryesisë i kësaj partie, Bekim Çollaku, kanë vizituar të hënën liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët nga

nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Me këtë rast, Çitaku ka thënë se liderët e UÇK-së janë duke u mbajtur pengë. “Thaçi, Veseli, Krasniqi e Selimi kanë krijuar historinë. Sfidat dhe pengesat që kanë kaluar në jetë kanë qenë

shumëfish më të mëdha sesa sfida në të cilën po kalojnë sot. Ata nuk janë të burgosur. Ata po mbahen peng. Megjithatë, edhe pas kësaj vizite te presidenti Thaçi, dolëm optimistë në ngadhënjimin e drejtësisë. Bashkë me Arlindën, Bekimin dhe Abelardin”, ka shkruar Çitaku.

Zëvendësministri i Jashtëm kërkon ndihmën e Finlandës për proceset integruese

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen. Zëvendësministri Ahmeti në takim me ambasadorin Nissinen vlerësoi bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve, të cilat tha se janë treguesi më i mirë i vullnetit politik për një

partneritet dhe mbështetje të vazhdueshme për proceset të cilat janë me rëndësi të madhe për Kosovën dhe Finlandën. Ahmeti dhe Nissinen gjatë këtij takimi diskutuan për bashkëpunimin dypalësh, procesin e integritimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, me theks të veçantë anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, për çka

Ahmeti përshëndeti rolin mbështetës dhe aktiv të Finlandës. Ndërsa ambasadori Nissinen ka falënderuar zëvendësministrin Ahmeti për bashkëpunimin e ofruar, njëherësh ka shprehur gatishmërinë që raportet në mes të Kosovës dhe Finlandës të thellohen më tej, duke shfrytëzuar mundësitë e bashkëpunimit shumëdimensional mes të dy vendeve.



Pozitë e opozitë përkujtojnë 24-vjetorin e masakrës në Abri të Epërme

DRENAS, 26 SHTATOR - Të hënën janë bërë 24 vjet prej kur më 26 shtator 1998 forcat serbe vranë dhe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu në fshatin Abri e Epërme të Drenasit. "Çdo vit më 26 shtator, në përvjetorët e masakrës së Abrisë, kujtohem që 23 të vrarët e kësaj masakre nuk mund të përkujtohen pa Imer Deliu, familjarin e gjallë të tyre që jeton mes nesh. Është ai që na ka rrëfyer me shumë dinjitet atë çfarë ndodhi më 26 shtator 1998, ashtu siç ai i pa kur i gjeti kufomat e familjarëve dhe të afërmeve të tij të masakruar nga trupat serbe. Që nga atëherë dëshmia e Imer Deliu ka mbetur pa u marrë në shqyrtim nga drejtësia ndërkombëtare dhe ende askush nuk është akuzuar për masakrën e Abrisë", ka shkruar kryeministri Albin Kurti në "Facebook".

E dëshmuar edhe nga mediet ndërkombëtare, Kurti ka thënë se masakra e Abrisë është një nga krimet më të tmerrshme të gjenocidit që Serbia ka kryer mbi shqiptarët e Kosovës. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka qëndruar të hënën në Abri për t'i përkujtuar viktimat e masakrës së tmerrshme që ndodhi 24 vjet më parë. "Fëmijë, gra, të rinj, pleq, asnjërit prej tyre nuk iu kursye jeta nga xhandarmëria serbe, e cila kishte nisur spastrimin etnik, në cak rajonin e Drenicës, për të vazhduar gjithandëj trojeve të Kosovës, me sulme veçmas ndaj popullsisë civile, të pambrojtur", ka thënë Haxhiu. Ajo ka thënë se krimet e luftës në Kosovë janë plagë për të cilat



drejtësia është e vetmja rrugë që ta zbehë sadopak dhimbjen për ta. "Do të angazhohemi për drejtësinë për të gjithë viktimat e krimit, duke kujtuar e përkujtuar secilën ngjarje tmerruese të cilën e përjetoi populli shqiptar nga regjimi i Serbisë", ka thënë ministrja Haxhiu.

Masakrën e Abrisë e ka përkujtuar edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka theksuar se e kjo masakër, sikur edhe mbi 400 masakrat e tjera të kryera nga Serbia në Kosovë, janë dëshmi se ky shtet okupator synonte t'i shfaroste shqiptarët me tërë arsenalin ushtarak dhe

me metodat më barbare të mundshme. Ndërkaq lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se 26 shtatori shënon ngjarje të rëndësishme për historinë tonë, sa krenare aq dhe tragjike. "Më 1998 heroikisht do të bien në përballje me armikun, mësuesi

Vesel Demaku me dy nxënësit e tij, Valdet Xhemajli dhe Afrim Hajdari. Po atë ditë, barbarët ekzekutuan familjen Delia, po në Abri, pa kursyer askënd nga foshnja disamuajshe e deri te plaku nëntëdhjetekatërveçar", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Latifi takon ministren Hajdari, flasin për investimet në Parkun Industrial në Opterushë

RAHOVEC, 26 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, është takuar me ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, me të cilën ka biseduar për investimet në Zonën Ekonomike - Parkun Industrial në Opterushë. "Nga ministrja Hajdari mora konfirmimin se MINT do ta përkrahë me 1,5 milion euro këtë projekt të rëndësishëm për biznese, zhvillim ekonomik dhe punësim. Pra,

sipas marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëfinancim të nënshkruar me MINT, MINT përkrah me 1,5 milionë euro, ndërsa komuna e Rahovecit me 300 mijë euro. Ky investim kap vlerën gjithsej 1,8 milion euro", ka thënë kryetari Latifi. Ai ka theksuar se investimet në këtë zonë agro-industriale janë të një rëndësie të veçantë. "Falënderojmë MINT dhe KIESA si dhe ministren Rozeta Hajdari për gatishmërinë dhe

përkrahjen e dhënë për ta plotësuar synimin tonë të kamotshëm. Komuna e Rahovecit është zonë e rëndësishme ekonomike, agrare dhe industriale, e cila sjell përfitime financiare për qytetarët tanë si dhe për buxhetin e Republikës së Kosovës. Prandaj, konsiderojmë se investimet në zonën ekonomike - Parkun Industrial në Opterushë - janë hap i rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë në përgjithësi", ka thënë Latifi.



Reagim i KMDLNj-së

Vizita mashtruese e mashtrueses Ekaterina Trandafilova në Kosovë!

Kryetarja e Gjykatës Speciale në baza etnike dhe raciste, Ekaterina Trandafilova ishte në vizitë në Kosovë. Për shkak të protestës së paralajmëruar nga PSD-ja, e anuloi vizitën fizike në Gjilan për të bashkëbiseduar përmes rrjeteve sociale, siç deklaroi ajo, me shoqërinë civile dhe qytetarët dhe për t'i njoftuar me punën që e bënë Gjykata Speciale, kryetare e së cilës është. Më pastaj, në kushte gjysmilege vizitoi MD-në sikur që u takua në njërin nga hotelet e Prishtinës me studentë apo anëtarë të shoqërisë civile dhe, me gjasë, sipas burimeve të pakonfirmuara edhe me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Aktualisht, në Qendrën e Paraburgimit të Gjykatës Speciale mbahen peng tetë (8) qytetarë të Kosovës, dy, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, drejtues të OVL-së së UÇK-së të dënuar me dënim të shkallës së parë me dënime drakonike, tjetri Salih Mustafa - Cali, në pritje të shqiptimit të dënimit ku ZPS-ja ka kërkuar 35 vjet burgim duke injoruar faktin se gjatë shqiptimit të dënimit ka përparësi ligji i favorshëm për të akuzuarin në kohën kur dyshohet se është kryer krimi, është caktuar trupë gjyqesive kundër Pjetër Shalës për të cilin KMDLNj vlerëson se nuk do të zgjasë shumë kurse, për herë të parë, Ekaterina Trandafilova, prokurorja e Gjykatës Speciale në Hagë paralajmëroi se gjykimi ndaj udhëheqësve më të lartë të UÇK-së dhe institucioneve të Kosovës; Jakup Krasniqi, dy herë kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe për një afat të caktuar u.d. i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ministër për Punë të Jashtme, kryeministër i Kosovës dhe në çastin e arrestimit president i Kosovës, Kadri Veseli, në mandatin e dytë si kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe Rexhep Selimi, shef i GP të Lëvizjes Vetëvendosje, mund të fillojë në fund të këtij viti apo në fillim të vitit 2023 pasi kishte shumë kundërshtime se po mbahen në paraburgim përtej kohës së arsyeshme dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria. Gjykata Speciale dhe kryetarja e saj thirren se janë pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës vetëm



kur duan të krijojnë alibi për shkeljet e shumta të të drejtave të njeriut në ndërkohë që nuk i japin llogaridhënie asnjë institucioni në Kosovë, qoftë Kuvendit të Kosovës ku dhunshëm ishte votuar për themelimin e kësaj gjykate e lëre më Ministrinë e Drejtësisë që nuk e bëjnë hesap fare përveç nëse duan ndonjë informatë që është në kundërshtim me interesat e Kosovës apo faturimi i shpenzimeve për viktimat, jo sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, por sipas standardeve të kësaj gjykate. Është një kërkesë e turpshme dhe kërcënuese që ZPS-ja dhe Gjykata Speciale, në formë pyetësori i dërgon Ministrisë së Drejtësisë pikërisht për mënyrën e kompensimit të viktimave dhe, pas marrjes së përgjigjes, përsëri ka kërkuar sqarime sepse nuk është në përputhje me pritjet.

Ekaterina Karanfilova thotë se janë mbi 1 milion faqe të materialeve për rastin e katër të akuzuarve të posteve më të larta institucionale në Kosovë, pa treguar se sa janë nga Serbia e që KMDLNj mendon se shumica janë nga Serbia.

Pas shumë kundërshtimeve të avokatëve mbrojtës dhe ndërkombëtare sikur edhe disa rasteve sporadike të organizatave vendore, orët e kërkuara nga ZPS (mbi 1670) janë ulur në 709 e që sipas KMDLNj-së janë shumë për faktin se e zgjasin procesin

gjyqësor. Edhe kjo paraqet presedan krahasuar me proceset e mëparshme në Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë. Në vërejtjet për fshehjen e provave shfajësuese për të akuzuarit, kryetarja vetëm thotë se ato duhet të dorëzohen, pa e saktësuar afatin e paraparë me Rregulloren e Punës.

Për vonesën e madhe të përkthimit të materialeve në gjuhën shqipe (disa vendime dhe aktgjykimet e kompletuara dorëzohen me muaj të tërë vonesë), kjo thotë se ato po përkthehen intensivisht.

Në pyetjen se si është e mundur të dënohen me dënim aq të lartë për pengim të administrimit të drejtësisë, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati ndërsa nuk ka asnjë përgjegjësi sepse nuk është bërë asnjë hetim për rrjedhje, shitje apo kontrabandim të materialeve të ndjeshme nga kjo gjykatë, kryetarja thotë në mënyrë cinike dhe të pandershme se përgjegjësitë janë të ndara midis ZPS-së dhe DHS-së duke i arsyetuar këta dy mekanizma anues dhe represiv.

Asgjë nuk thotë kur avokatët vendas trajtohen si punëtorë krahu nga kjo gjykatë dhe se vizat hyrëse u lejohen vetëm në kohëzgjatje që maten me ditë që përmbajtësisht paraqet pengesë për përgatitjen e një mbrojtje efektive.

Me një arsyetim krejtësisht të pandershëm se gjykata nuk është njëetnike për faktin se

kërkesat për njohje të statusit të viktimës janë të përkatësive etnike të ndryshme e mësuh faktin se të gjithë të paraburgosurit, të akuzuarit dhe sigurisht edhe të dënuarit janë shqiptarë, shtetas të Kosovës apo të vendeve tjera, gjithashtu shqiptarë. Sikur që të gjithë të ftuarit për intervistë janë shqiptarë.

Të gjithë të punësuarit, në të gjitha nivelet në Qendër të Paraburgimit, në ZPS, DHS, administrata, oficerët dhe madje edhe përkthyesit janë të huaj, asnjëri nuk është shqiptarë.

Kryetarja e Gjykatës Speciale Raciste në Hagë, Ekaterina Trandafilova ka ndërtuar raport klientelist me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, të ashtuquajturin Avokat i Popullit i DHS-ara dhe Avokatin e Popullit të Holandës për monitorimin e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria duke siguruar, në këtë mënyrë një mungesë të plotë të transparencës dhe llogaridhënies.

Nuk paraqet asnjë arsyetim pohimi se tre (3) dëshmitarë - viktimat i janë nënshtruar trajtimit psikologjik kur, në të njëjtën kohë u mohohet e drejta dhjetëra mijëra - viktimave në Kosovë u mohohet e drejta elementare e njeriut për t'u informuar dhe për të drejtën për drejtësi, vetëm se janë shqiptarë! Asnjëherë kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trandafilova

nuk ka reagu kundër shkeljes flagrante e parimit të prezumimit të pafajësisë nga kryeprokurori i ZPS-së që, pa filluar ende procesi gjyqësor dhe pa një vendim të gjykatës përkatëse, disa herë, publikisht ka deklaruar se Hashim Thaçi dhe të tjerët do të dënohen me burg të përjetshëm andaj, me këtë diversion moral dhe juridik e ka arsyetuar vendimin për paraburgim.

Kryetarja e Gjykatës Speciale në Hagë në mënyrë skajshmërisht të pandershme, moralisht dhe profesionalisht ka devijuar përgjegjësinë e Raportit të Dik Martit përkatësisht pjesës ku flitet për trafikim me qenie njerëzore dhe organe e që ka shërbyer si mjet kryesor presioni për formimin e kësaj gjykate.

KMDLNj nuk është i kënaqur as me shërbimet shëndetësore që u ofrohen personave të privuar nga liria.

KMDLNj do ta pranonte këtë gjykatë si të duhur dhe të paanshme vetëm nëse do t'i trajtonte në mënyrë të barabartë të gjitha viktimat, pa bërë asnjë dallim në baza etnike dhe të tjera dhe që do të kërkonte përgjegjësi për të gjithë ata që planifikuan krimin, e bënë krimin apo nuk e penguan, gjithashtu pa bërë asnjë dallim. Kjo Gjykatë nuk është e tillë prandaj, nga aspekti i të drejtave të njeriut është njëetnike dhe puro raciste.

KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon nga institucionet e Kosovës që të kërkojnë një proces fer dhe të paanshëm që nuk kushtëzohet nga kërkesat e politikës ditore apo përkatësisë etnike. Kjo është detyrim i institucioneve e që, në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si ndërhyrje në drejtësi!

Për të siguruar këto kushte për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikueshëm politikisht, KMDLNj thërret organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ta monitorojnë tërë procesin e gjykimin që ende nuk ka filluar e që nuk e kanë bërë për proceset kundër Nasim Haradinaj, Hysni Gucati dhe Salih Mustafa.

Nëse nuk sigurohet drejtësi për të gjitha viktimat kjo është një drejtësi selektive dhe nga aspekti i të drejtave të njeriut është e papranueshme. Kjo Gjykatë pikërisht e zbaton drejtësinë selektive.

Të enjten mbahet seanca plenare e radhës

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Këtë të enjte Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mbledhet në seancë të re plenare, kështu vendosi të hënën Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e përbashkët me përfaqësues të grupeve parlamentare të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca.

Seanca e së enjtes do të fillojë

me deklarimet jashtë rendit të ditës, për të vijuar me pyetjet parlamentare.

Seanca do të vazhdojë me shqyrtimin e parë të Projektligjit për sanksionet e shënjestruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut, Projektligjit për Antidopingun dhe atij për edukimin në fëmijërinë e hershme.

Në këtë seancë pritet edhe formimi i Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarë të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komunitetit shqiptar.

Pas përfundimit të seancës së re, Kuvendi do t'i rikthehet shqyrtimit të pikave nga seancat e papërfunduara.



Hoxhaj: Nga 1 janari të hyjë në fuqi Ligji i Pagave

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se qeveria dhe sindikatat duhet të bëjnë një zgjidhje për grevën që mënyrë që të fillojë procesi mësimor.

Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës në një konferencë për medie mbajtur të hënën, pas mbledhjes së kryesisë, është shprehur se nga 1 janari i vitit të ardhshëm të hyjë në fuqi Ligji i Pagave që, sipas tij, do ta zgjidhte këtë problem. "Kemi

pasur një seancë dhe debat parlamentar për çështjen e grevës, qëndrimi ynë si PDK ka qenë që të gjendet një zgjidhje e cila është e përkohshme që qeveria me sindikatën të bëjnë zgjidhje afatshkurtër dhe prej 1 janarit të jetë në fuqi Ligji i Pagave i cili duhet ta zgjidhë këtë problem", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka treguar se janë humbur shumë orë nga mbajtja e kësaj greve. "Kërkesa jonë është që greva të ndërpritet, që nxënësit të kthehen në shkolla dhe njëherën anë të plotësohen

kërkesat minimale që ka SBASHK-u. Ne si subjekt politik nuk e luajmë rolin e zëdhënësit të sindikatës, por mendojmë se janë humbur shumë ditë të procesit mësimor", ka thënë Hoxhaj.

Kuvendi do të mbledhet këtë javë për seancë të re si dhe pikat e papërfunduara nga seancat e kaluara. Projektligji për Paga për Sektorin Publik, duke filluar nga 15 shtator, ka dalë në konsultim publik, ku të gjitha palët do ta kenë mundësinë t'i japin mendimet e tyre për 15 ditë pune.



KEK-u ndal bllokun A3



PRISHTINË, 26 SHTATOR - Njësitë A3 e termocentralit "Kosova A" është ndalur të dielën si pasojë e veprimit të mbrojtjes në ndërpresin e gjeneratorit. Siç bën me dije Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ekipet profesionale të KEK-ut dhe KOSTT-it janë duke punuar për identifikimin e burimit që ka shkaktuar këtë ndërprerje. "Ekipet

profesionale të KEK-ut dhe KOSTT-it janë duke punuar për identifikimin e burimit që ka shkaktuar veprimin e kësaj mbrojtje dhe për ta mundësuar rikthimin e sigurt të njësisë në punë në kohë optimale. Lidhur me këtë, KEK-u ka ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për mbulimin e mungesave të paraqitura si pasojë e daljes së njësisë A3 në mënyrë që kjo

ndalje të mos reflektojë në mungesë të energjisë për qytetarët e vendit", thuhet në njoftimin e KEK-ut.

Korporata thotë se lidhur me veprimet për ditët vijuese qytetarët do të njoftohen me kohë. Kujtojmë se për disa ditë A3 kishte qenë jashtë funksionit, por që nga 1 shtatori ishte kthyer në punë së bashku me bllokun B2.

Odat Amerikane të rajonit pajtohen për fuqizim të bashkëpunimit

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Oda Amerikane në Shqipëri, Oda Amerikane në Bosnjë-Hercegovinë, Oda Amerikane në Kosovë, Oda Amerikane në Maqedoninë e Veriut dhe Oda Amerikane në Serbi, të mbledhura në konferenca Qytetet Intelgjente në Tiranë, janë pajtuar për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe promovimit të mundësive për zhvillim.

Odat Amerikane u morën vesh ta vazhdojnë punën e përbashkët për avokim për klimë më të mirë afariste dhe të investimeve, si dhe për inkurajimin e largimit të barrierave tregtare dhe fuqizimin e lëvizjes së lirë të kapitalit, njerëzve, mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu,

Odat Amerikane u zotuan të punojnë bashkërisht për t'i eksploruar mundësitë e pashfrytëzuara duke fuqizuar lidhjet e Odave Amerikane në rajon.

Duke u përballur me sfida të shumta, përfshirë sigurinë energjetike, mungesën e kapitalit njerëzor, çrregullimet në zinxhirët e furnizimeve, barrierat tregtare, sigurinë kibernetike dhe çështjet klimatike, Odat Amerikane u bëjnë thirrje udhëheqësve të rajonit që t'i përshpejtojnë reformat dhe bashkëpunimin, duke bashkërenduar ekonomitë me rregullat e BE-së, agjendën digjitale dhe të gjelbër, si dhe avancimin e marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Kuvendi Komunal i Mitrovicës miratoi buxhetin për vitin 2023



MITROVICË, 26 SHTATOR - Nën drejtimin e kryesueses Vesa Broja dhe në prani të kryetarit të komunës Bedri Hamza, nënkryetarit Arian Tahiri, drejtorëve komunalë dhe asamblistëve, të hënën është mbajtur seanca e 12-të e rregullt e Kuvendit të komunës.

Kryesuesja Broja ka propozuar rendin e ditës për miratim, me ç'rast asamblistët e Kuvendit unanimisht e kanë aprovuar këtë rend dite.

Pika kryesore e rendit të ditës

për këtë mbledhje ishte shqyrtimi i draft-buxhetit komunal për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025, ku në fjalën e saj, drejtoresha për Buxhet dhe Financa, Igballe Islami, ka sqaruar para asamblistëve mënyrën e hartimit të buxhetit, procedurat e ndjekura të parapara me ligj dhe prioritetet e parapara në shpenzimin e mjeteve buxhetore.

Me këtë rast, drejtoresha Islami ka njoftuar se buxheti i komunës së Mitrovicës për

vitin 2023 planifikohet të jetë 25,011,350.00 euro, ku burimet e fondit të buxhetit janë granti i përgjithshëm 9,725,479.00, granti i arsimit 8,522,968.00, granti i shëndetësisë 2,739,643.00, financimi i teatrove 169,890.00, shërbimet rezidenciale 180,000.00, si dhe të hyrat vetjake 3,673,370.00 euro. Pas diskutimeve të shumta asamblistët e Kuvendit Komunal aprovuan me shumicë votash buxhetin e komunës së Mitrovicës për vitin 2023.

29 vite në arrati | Pse nuk po arrihet të kapet bos i “Cosa Nostra”, Mateo Mesina Denaro?



Ditët e fundit drejtorja e Qarkut Anti-Mafia në Palermo, lëshoi 70 urdhra kundër disa njerëzve që banojnë në provincat e Palermos, Mesinës dhe Trapanit. Ato përfshinin kryesisht kontrolle në shtëpi, zyra, shtëpi rurale, dyqane, magazina në zonën e Belices.

Për 23 persona është vendosur masa e arrestit në burg, dhe 12 të tjerë janë lënë në arrest shtëpie. Mbi ta rëndojnë akuzat e lidhjeve me mafian, zhvatje, trafik droge, armëmbajtje pa leje etj. Prokurorët Françeska Desi, Pieraxhelo Padova dhe Alesia Sinatra, të koordinuar nga zëvendësprokurori Paolo Guido, besojnë se rrjeti i të dyshuarve vazhdon të punojë për kontrollin e territorit dhe garantimin e interesave ekonomike të Mateo Mesina Denaro, kreu i “Cosa Nostra” në kërkim që nga viti 1993, dhe më i kërkuari në Itali. Në përgjime Mesina Denaro njihet ne nofken Ignazieddu.

Por ai përmendet edhe si “vëllai i atij që ishte në bankë”. Në fakt një nga vëllezërit e tij punonte dikur në një degë të Banca Sicula. Hetuesit kanë përgjuar edhe dy të dyshuar të cilët flisnin për vdekjen e Mesina Denaro. Por një tjetër i dyshuar, deklaroi pak ditë më vonë: “Le ti bëjmë të besojnë se ka vdekur, ndoshta reduktojnë kërkimet për të”.

Operacioni i kryer nga ROS, grupi operacional special i karabinierëve, është vetëm i fundit në përpjekje për të kapur Mesina Denaro, njeriun që i zuri vendin Toto Rinës në krye të Korleonezëve, mafia dominuese pas arrestimit të tij në vitin 1993.

Mesina Denaro, që është nga Kastelvetrano, e ka udhëhequr mafian gjithnjë e më shumë brenda ekonomisë “legale”, duke e braktisur strategjinë e masakrave,

edhe pse ka qenë frymëzues dhe zbatues i disa të tillave gjatë vitit 1993 (shpërthimet me bomba në Firenze, atentati ndaj gazetarit Mauricio Kostanzo në Romë, shpërthimet me bomba në Milano dhe në Romë).

Francesco Geraçi, një mafioz që u bë bashkëpunëtor i drejtësisë ka deklaruar: “Një ditë në vitin 1992 Mateo më takoi dhe në një moment më pyeti se çfarë mendoja për një seri atentatesh që do të kryheshin kundër njerëzve të famshëm si Pipo Baudo, Kostanzo, Marteli, Santoro etj.

Ai tha se ato do ta destabilizonte shtetin. Unë u përgjigja: Në rregull. Ai më tha se së shpejti do të shkojmë në Romë për të kaluar kohë me VIP-at”. Një mafioz tjetër, Xhuzepe Graviano, u tha gjyqtarëve se në vitin 1992, se së bashku me Mesina Denaron, ai ishte në mesin e audiencës gjatë puntatës së radhës së emisionit Mauricio Kostanzo, në Teatrin Parioli në Romë. Një vit më pas, më 14 maj, ndodhi sulmi ndaj gazetarit dhe prezantuesit të njohur.

Policia nuk ka asnjë imazh të viteve të fundit të Messina Denaros. Vetëm një fotografi e vjetër dhe një identikit i vizatuar në bazë të përshkrimit të fundit të dikujt që e ka takuar disa vite më parë. Në gushtin e vitit 2021, një kasetë me zërin e tij të regjistruar në vitin 1992 u gjet në arkivin e gjykatës së Marsalas gjatë dëshmisë së tij në një gjyq.

Po ashtu ekziston edhe një video e shfaqur nga RAI 2 një vit më parë, në të cilën sipas disa dëshmitarëve Mesina Denaro ishte duke kaluar me një makinë në vitin 2009 në një rrugë në zonën e Agrixhentos. Mirëpo, nuk ka pasur asnjëherë konfirmim se njeriu që shfaqet për disa momente në atë video është vërtet ai.

Vitet e fundit është pretenduar se Mateo Mesina Denaro është parë në Amerikën e Jugut, Dubai, Britaninë e Madhe, Suedi, Holandë. Më 13 shtator 2021, një turist britanik, që po darkonte në restorantin “Het Pleidoi” në Hagë me dy persona të tjerë, u ndalua nga forcat speciale holandeze në një operacion spektakolar ku përfshiheshin shumë agjentë.

Sipas një raporti të marrë nga policia holandeze nga prokurori italian në Trento, ai njeri duhet të ishte Mateo Mesina Denaro. Por vetëm pas disa orësh, turisti anglez mundi t’u provonte atyre që po e mermin në pyetje se nuk ishte ai bos i mafies. Por shumë hetues janë të bindur se ai nuk largohet asnjëherë nga territori i tij: zona e Belices, midis Kastelvetranos, Trapanit, Marsalas dhe Agrixhentos. Ata e dinë se Bernardo Provcancano që qëndroi në arrati për 43 vjet përpara se të arrestohej më 11 prill 2006, në një fermë pranë Korleones, nuk kishte lëvizur asnjëherë nga territori i tij.

Por ky krahasim nuk vlen. Pasi Provcancano ishte pjesë e një mafie të vjetër rurale. Shtëpia ku u gjet dhe arrestua, dhe ku kishte kaluar vitet e fundit ishte gati një gërmadhë. Ndërkohë me aq a dihet, Mesina Denaro i ka qejf veshjet e bukura, jetën e mirë, i pëlqen të rrethohet me objekte arti (porositi vjedhjen e një zbulimi të rëndësishëm arkeologjik që ruhet në muzeun e Mazara del Vallo), i pëlqen të lexojë, dhe sipas atyre që e kanë njohur kur ishte i ri, besohet se është shumë inteligjent dhe një lloj revolucionari.

Miku i tij i fëmijërisë, Xhuzepe Fontana, i njohur si “Peppe Rocky”, menaxher i një restoranti në Selinunte, thotë për të: “Matteo është një njeri me një zgjuars mbi mesataren. Ai mund të kishte bërë

shumë për Sicilinë”. Kur nisi t’i fshihet policisë, ai i shkroi të dashurës së tij: “Më duhet të largohem. Nuk mund të t’i shpjegoj dot arsyet e zgjedhjes sime. Tani për tani gjërat po kthehen kundër meje. Jame duke luftuar për një kauzë që nuk mund të kuptohet. Por një ditë, do ta mësojmë se kush ishte në anën e arsyes”.

Në dallim nga shumë bosë të mafias të kapur midis viteve 1990 dhe fillimit të viteve 2000, Mesina Denaro është një i arratisur në një epokë në të cilën ata që e ndjekin atë kanë sisteme teknologjike më të fundit dhe bashkëpunim me forcat policore nga e gjithë bota. Kërkimi i tij nuk bëhet vetëm në territor, por edhe në rrjetet sociale, në të gjitha aplikacionet e mesazheve, madje edhe në seancat e lojërave online si Fortnite, në të cilat përdoruesit komunikojnë me njëri-tjetrin.

Në vitin 2020, gjykatësi Nino Di Mateo, që ka qenë gjithmonë i përfshirë në luftën kundër mafias, dhe që jeton i shoqëruar nga truproja që nga viti 1993 deklaroi: “Është shumë shqetësues fakti që arratia e Mateo Mesina Denaros, i dënuar me burgim të përjetshëm, po vazhdon prej 27 vjetësh. Ashtu siç ndodhi me arratinë e Provcancanos për 43 vjet. Situata të këtij lloji nuk mund të mos jenë pjesërisht rezultat i bashkëpunimit të institucionale dhe politikës italiane. Nuk është normale që për 27 vjet, apo 43 vjet, të mos mundet të kapet një i kërkuar”.

Vinçenzo Kalkara, ish-drejtuës i mafias në Kastelvetranos, tashmë bashkëpunëtor i drejtësisë, konfirmoi ekzistencën në të kaluarën të një marrëdhënie të ngushtë midis lozhës masonike të Kastelvetranos, Kampobelos dhe Trapanit dhe grupimit mafioz të

zonës. Anëtarësimi në këto lozha u ofron pjesëtarëve të mafias një mjet për të fituar favore në shumë fusha, për të përfunduar një punë, dhe kur është e nevojshme edhe ndihmë për t’u fshehur.

Në një libër të Françesko Forxhones dhe Paolo Mondanit “Përtej Kupolës”, përmendet një episod i rrëfyer nga ish-mjeshtri i madh i Orientit të Madh të Italisë (institucioni më i vjetër masonik italian) Xhulio Di Bernardo për prokurorin e Palmit. Pas masakrave në të cilat u vranë Falkone dhe Borselino, në një takim të mjeshtrave të mëdhenj të lozhave siciliane, presidenti Oracio Katarsini, propozoi miratimin e një dokumenti që vërtetonte pozicionin e Masonerisë në lidhje me mafian.

“Menjëherë pas atij takimit, Katarsini më telefonoi në Ishujt Kanarie ku isha me pushime, duke më thënë se ishte i shqetësuar për mungesën e miratimit të dokumentit, që e kishte hutuar dhe nuk dinte sesi ta interpretonte”. Denaro është mafiozi i fundit ende i lirë që dinte gjithçka për masakrat e vitit 1993, përfshirë vrasjet e Falkones dhe Borselinos.

Po ashtu është hedhur hipoteza se ai zotëron dokumente që i përkasin Toto Rinës, me të cilat do të shantazhonte figura të rëndësishme të politikës dhe biznesit. Asnjë nga bashkëpunëtorët e drejtësisë, nuk ka dhënë ndonjëherë indikacion se ku mund të jetë Mesina Denaro. Shumë njerëz e mbrojnë edhe sot e kësaj dite, ndoshta edhe nga frika. Në një nga shënimet e tij në letra të vogla, me të cilat komunikon zakonisht, dhe që përfundoi në duart e hetuesve ai shkruante: “Me njerëzit që kam vrarë mund të mbushja një varrezë!”.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova synon fitoren kundër Qipros

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës synon fitoren në ndeshjen kundër Qipros, e cila zhvillohet në stadiumin 'Fadil Vokrri' sonte (e martë) në orën 20:45. Fitorja do t'ia mundësonte "Dardanëve" ta mbajnë pozitën e dytë në Grupin 2 të Ligës C në Ligën e Kombeve, teksa me barazim nuk do të rrezikonte rënien në Ligën D. Përzgjedhësi Alain Giresse në konferencën për media ka thënë se objektivi i vetëm në këtë ndeshje është fitorja. "E kemi ndeshjen e radhës. Synimi ynë është fitorja. Portieri Arijanet Muric e ka lënduar njëjtë e këmbës në Belfast dhe nuk jam i sigurt nëse do të jetë i gatshëm për lojë. Po ashtu, në dyshim mbetet edhe Amir Rahmani edhe pse ai është përmirësuar dukshëm", ka theksuar Giresse. Trajneri francez ka thënë se është i fokusuar te fitorja dhe nuk mendon në aspektin negativ. "Sa i përket përvojës sime te Kosova, deri më tani jam i kënaqur me kushtet e punës që janë shumë të mira. Synimi im është të përparojmë dhe të ngrihem në nivel tjetër, por edhe të sjellim lojtarë të rinj. Kur e përgatisim një ndeshje, e përgatisim për ta fituar, sepse askush nuk dëshiron humbje. A po mendoni që shumë trajnerë i

përgatisin dorëheqjet e tyre? Fillimisht asnjë trajner nuk mendon ta humbë ndeshjen", ka shtuar Giresse. Ndërkaq, qendërmbrojtësi Mirlind Kryeziu, i cili në ndeshjen kundër Irlandës së Veriut mungoi për shkak të pezullimit të kartonëve, theksoi se të gjithë lojtarët duan që këtë ndeshje ta fitojnë, në mënyrë që këtë edicion të Ligës së Kombeve ta mbyllin në pozitën e dytë. "E dimë që është ndeshje e rëndësishme për ta mbajtur vendin e dytë në grup dhe duam ta fitojmë. Ishim të zhgënjyer pas humbjes nga Irlanda e Veriut, pasi bazuar në lojën që e kemi luajtur rezultati nuk ka qenë real dhe nuk e kemi merituar humbjen. Por, këto ditë e fundit i kemi kaluar shumë mirë, kemi qëndruar bashkë dhe gjithçka ishte pozitive. Kështu që na mbetet ta fitojmë ndeshjen për ta mbyllur këtë edicion me fitore. I kemi analizuar gabimet nga ndeshja e parë, por e kemi analizuar edhe lojën e Qipros. Kështu që besoj se do të bëjmë një paraqitje edhe më të mirë dhe pa gabime", ka theksuar Kryeziu. Pas konferencës, "Dardanët" e kanë mbajtur stërvitjen e fundit, ku Amir Rahmani ka qenë aktiv gjatë tërë kohës, derisa Arijanet Muriq ka pushuar me qëllim që të rikuperohet nga lëndimi.



Toppesëshja dhe MVP i javës së tretë në Superligë

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Në fundjavë u zhvillua xhiroja e tretë në elitën e basketbollit të Kosovës. Ponte Prizreni regjistroi fitoren e parë këtë edicion, duke mundur rivalin lokal, Bashkimin, 93:101. Te Ponte u dallua organizatori amerikan Wayne Arnold me 33 pikë e pesë kërcime, duke u shpallur edhe MVP i kësaj xhiroje. Ai u ndihmua nga qendra Urim Zenelaj me dyshifror të dyfishtë me 13 pikë e 11 kërcime. Sigal Prishtina shënoi fitore të thellë ndaj Vëllaznimit (99:81), ku u dallua Dustin Thomasi me 32



pikë, shtatë kërcime dhe tri asistime. Derbin e kësaj jave e fitoi Peja, duke mundur Golden Eagle Yllin, ku basketbollisti më i mirë te vendasit ishte Brad Waldow me 15 pikë e 13 kërcime, duke ndihmuar vendasit ta

regjistrojnë fitoren e tretë në këtë edicion. Fitoren e tretë e shënoi edhe Trepça, që mundi Rahovecin në udhëtim. Te mitrovicasit më i miri në parket ishte Drilon Hajrizi me 18 pikë, dhjetë kërcime e pesë asistime.

TOPPESËSHJA

Wayne Arnold (Ponte Prizreni) 33 pikë, 5 kërcime
Dustin Thomas (Sigal Prishtina) 32 pikë, 7 kërcime, 3 asistime
Brad Waldow (Peja) 15 pikë, 13 kërcime
Drilon Hajrizi (Trepça) 18 pikë, 10 kërcime, 5 asistime
Urim Zenelaj (Ponte Prizreni) 13 pikë, 11 kërcime, 3 asistime

Rekrutohen 61 gjyqtarë të rinj, avancohen 73 të tjerë



PRISHTINË, 26 SHTATOR - Komisioni i Gjyqtarëve, në krye me Përparim Hasanin, në mënyrë që t'i plotësojë nevojat që dalin për mbulimin e të gjitha ndeshjeve në të gjitha kategoritë, ka bërë

rekrutimin e gjyqtarëve të rinj nga të gjitha rajonet e Kosovës. Këtij rekrutimi i ka paraprirë thirrja e cila është bërë për aplikim në regjionet përkatëse. Përgjatë tre muajve janë mbajtur ligjëratat

teorike dhe fizike dhe në bazë të performancës dhe aftësive të tyre, këta gjyqtarë iu kanë nënshtruar testeve finale, ku kanë arritur të kalojnë 61 gjyqtarë. Në të njëjtën kohë, në bazë të testimeve dhe

performancës së tyre, është bërë edhe avancimi i gjyqtarëve të cilët kanë qenë të pajisur me kategorinë e katërt dhe 73 prej tyre janë avancuar në kategorinë e tretë.

Munishi para derbit me Dritën: Do të tregojmë se sa e madhe është Prishtina

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Të mërkurën zhvillohet derbi në mes të Prishtinës dhe Dritës.

Trajneri Ismet Munishi ka thënë se Prishtina do të tregojë se sa e madhe është. "Të mërkurën do

të tregojmë se sa e madhe është Prishtina, sepse 'rrethet' kanë filluar ta çojnë kokën si shumë.

'Plisat' do të bëjnë atmosferë siç i ka hije klubit më të madh shqiptar", ka thënë Munishi.



Messi: Me Neymarin njihemi përmendsh, Mbappe është një bishë

PARIS, 26 SHTATOR - Leo Messi ndryshoi skuadër por, për fatin e mirë të "pleshtit", edhe në Paris gjeti partner sulmi fantastik. Së bashku me Neymarin, mikun e tij të vjetër, të PSG gjeti edhe Kylian Mbappe, të tre kanë formuar një tredhëmbësh fantastik. Ndryshe nga Neymari,

Messi ishte më "diplomat" kur u pyet për partnerët e tij të sulmit. "Unë me Neymarin e njohim njëri-tjetrin përmendsh, jemi argëtuar shumë kur ishim te Barcelona. Do të kisha dashur të luaja më shumë ndeshje me të në Spanjë, por jeta kështu është, na bëri që të bashkoheshim në

Paris. Kylian është një futbollist ndryshe, është një bishë, është shumë i fortë në duelet një kundër një, është shumë i shpejtë. Ai është një futbollist shumë i kompletuar, këtë po e vërteton prej kohësh, sigurisht është një nga më të mirët në botë", ka thënë Messi.



Largimet e trajnerëve dhe humbjet e çuditshme të kombëtares shqiptare

TIANË, 26 SHTATOR - "Dashuria" e Armand Dukës me trajnerët e huaj në këto 20 vjet që drejton FSHF-në ka pasur thujtë të njëjtin stil edhe kur palët janë ndarë. Ka qenë "deja vu" me largimet e tyre, pasi në mes kanë qenë humbje të shoqëruara me mister dhe të çuditshme, edhe pse në futboll gjithçka mund të ndodhë. Situata është komplikuar në momentin kur kanë folur trajnerët dhe mënyra se si FSHF-ja përgatiste terrenin për t'i larguar. Nga Bepe Dosena, tek Oto Bariç, Arie Haan dhe Josip Kuzhe e deri tek i fundit: Christian Panucci. Por, tashmë të njëjtin fat mund të ketë edhe Edi Reja, i cili gjithsesi është në fund të kontratës dhe pas dështimit për ta kapur vendin e parë në grup në Ligën e Kombeve, natyrisht që situata nuk është aspak në favor të tij për një rinovim. Duka është treguar i kujdesshëm në deklarata që ka bërë për Rejen, por që gjithsesi ka lënë të kuptohet se të ardhmen nuk e shikon me italianin, i cili më 10 tetor mbush 77 vjeç.

Dosena

Italiani njoftoi FSHF-në më 11 nëntor 2002 nëpërmjet një letre drejtuar presidentit Duka, se dorëhiqej nga kombëtarja me motivacionin e mospërshtatjes me mjedisin shqiptar përreth ekipit. Duka deklaronte në atë kohë se nuk



ia kishte pranuar dorëheqjen trajnerit Dosena, duke e bërë shkaktar të prishjes së planeve të kombëtares. Italiani u largua pak javë pasi Shqipëria kishte humbur 4-1 në Rusi.

Bariç

Humbjet 2-4 në "Qemal Stafa" me Bjellorusinë dhe turpërimi 6-1 në Rumani detyruan të ndjerin Oto Bariç të jepte dorëheqjen nga drejtimi i Shqipërisë në nëntor të vitit 2007. Kroatit dha disa deklarata të forta për mënyrën se si shkuan ndeshjet e fundit.

Haan

Hollandezit iu përgatit terreni për ta shkarkuar pas barazimit 0-0 me

Maltën më 11 shkurt 2009. Më pas FSHF-ja zyrtarizoi largimin e trajnerit pas humbjes 3-0 në Danimarkë më 1 prill 2009.

Kuzhe

I ndjeri kroat u largua pas humbjes së çuditshme 2-1 ndaj Luksemburgut në transfertë. Në shtator të vitit 2011 u tha se ishte ndarje konsesuale, teksa FSHF-ja e kishte marrë prej kohësh vendimin.

Panucci

Largimi i italianit ndodhi pas humbjes 0-2 me Turqinë në "Loro Boriçi", më 22 mars 2019, por vendimi për shkarkimin ishte marrë prej kohësh, për më tepër në tribunë në atë ndeshje ishte Edi Reja.

Kroosi në Serinë A, ëndrra e madhe mund të kthehet në realitet

MADRID, 26 SHTATOR - Nuk është një moment i thjeshtë ai që po kalon Juventusit i Massimiliano Allegrit. Pas humbjes së befasishme kundër Monzas, "Zonja e Vjetër" duhet të reagojë me kthimin në fushë pas ndeshjeve të kombëtareve. "Bardhezinjtë" do të luajnë kundër Bolognas në kampionat, një ndeshje nga e cila mund të varet edhe e ardhmja e trajnerit livonez. Jashtë fushës drejtuesit e klubit vazhdojnë të jenë të kujdesshëm për mundësitë që ofron merkato. Dhe mes ëndrrave të mëdha është akoma gjallë ajo e Toni Kroosit, një nga shtyllat e Real Madridit. Me kontratën që i skadon në 30 qershorin e ardhshëm, e ardhmja e Kroosit mund të mos jetë më te Real



Madridi. Kampioni gjerman, datëlindja 1990, është një element shumë i rëndësishëm i ekipit të Ancelottit. Megjithatë, oferta për rinovimin që "Los Blancos" i kanë bërë lojtarit duket se nuk e kënaq ish-yllin e Bayern Munichut. Kontratë njëvjeçare është oferta e Perezit, me Kroosin që kërkon një marrëveshje të paktën deri në 2025-n. Një distancë kjo që mund t'i hapë rrugën një skenari të bujshëm verën

e ardhshme, kur lojtari mund të lirohet me kosto zero dhe të transferohet diku tjetër për një aventurë të fundit të madhe në karrierën e tij. Në radhë, tashmë prej vitesh, është Juventusit që e pëlqen shumë Kroosin dhe do të donte ta merrte për të përforcuar një mesfushë që në javët e fundit ka treguar se është shumë në vështirësi. Duhet bërë kujdes edhe ndaj Manchester Cityt të Pep Guardiolas, klubi në pole position për ta siguruar firmën e mundshme të 32-vjeçarit gjerman. Kroos, në këtë sezon, ka koleksionuar 8 ndeshje, me 2 asistime dhe 533 minuta në fushë nën drejtimin e Ancelottit mes La Ligës, Ligës së Kampionëve dhe Superkupës së Evropës.

SHKURT

'El Clasico' zhvillohet më 16 tetor

Tashmë zyrtarisht është vendosur data dhe ora se kur do të luhet "El Clasico" mes Real Madridit dhe Barcelonës, me sfidën që do të zhvillohet në "Santiago Bernabeu". Kjo ndeshje që pritet me interesim të jashtëzakonshëm nga të gjithë tifozët do të zhvillohet më 16 tetor në orën 16:15. Por përpara se dy skuadrat do të përballen mes tyre, ata duhet të luajnë në Ligën e Kampionëve, ku Barça do ta sfidojë Interin në "Camp Nou" më 12 tetor, ndërsa "Los Blancos" do të udhëtojnë në Poloni, ku do të sfidojnë Shakhtar Donetsk më 11 tetor.

Kaçe vazhdon karrierën në Lituani

Ergys Kaçe do ta vijojë karrierën në Lituani. Ish-mesfushori i Partizanit ka firmosur me skuadrën FK Panevezys pas përvojave që ka kaluar edhe në Greqi dhe Republikën Çeke. Kaçe pjesën më të madhe të karrierës e ka kaluar te skuadra e PAOK, që e ka huazuar edhe në klube të tjera si Anagennisi, Epanomis dhe Panathinaikos, ndërkohë që tek Aris dhe Veria kaloi si lojtar i lirë.

Rahoveci përforcohet me Mandersonin

KB Rahoveci ka njoftuar se ka nënshkruar me amerikanin Isaiah Manderson. Manderson është i gjatë 208 cm dhe luan në pozitën 5. "Qendra Amerikane vjen te skuadra jonë pas një përvoje të gjatë në basketbollin evropianë dhe atij latino-amerikan", thuhet në njoftim. Në të kaluarën Manderson është paraqitur në ligat elitare të Qipros, Maqedonisë Veriore, Islandës, Sllovenisë, Porto Rikos, Zvicrës, Uruguait dhe, po ashtu, në kolegjet universitare të ShBA-së. Isaiah Manderson së fundmi është paraqitur te skuadra Qipriote Apop Parphou ku luajti me mesatare prej 18.7 pikësh për ndeshje dhe 9.2 kërcime për ndeshje.

Matthaus: Anglia është favorite për ta fituar Kupën e Botës

Pavarësisht prej paraqitjeve të dobëta në Ligën e Kombeve, duke zbritur në Ligën B pas humbjes në "San Siro" ndaj Italisë, legjenda e futbollit gjerman, Lothar Matthaus, është i bindur se Anglia është ende një nga kandidatët kryesorë për ta fituar Kupën e Botës. "Kur shihni emrat e lojtarëve, Anglia është favorite për ta fituar Kupën e Botës. Anglia dhe Franca mund të kenë nga tri skuadra kryesore secila. Vendi i katërt në Botërorin e Rosisë, finalja e Evropianit të fundit, anglezët janë shumë afër fitimit të një titulli pas vitit 1966", ka thënë Matthaus, i cili dyshimin e vetëm e ka te portieri. "Ndoshta Anglia ka një problem me portierin. Fjala vjen, nuk ka një portier si Gjermania. Ky mund të jetë një problem i madh. Në Kupën e Botës ju nevojitet çdo lojtar", ka shtuar Matthaus.

Deschamps: Franca e Botërorit do të jetë ndryshe

Franca pësoi humbje nga Danimarka në ndeshjen e fundit të Grupit 1 në Ligën A në Ligën e Kombeve (2-0). Trajneri Didier Deschamps pas kësaj humbjeje ka thënë se në "Katar 2022" do të jetë

një paraqitje ndryshe. "Humbja nuk na pëlqen asnjëherë, por sot patëm shumë raste. Fakti që nuk i shfrytëzuam sollí këtë rezultat. U mundova të korrigjoj diçka me modulim

dhe lojtarët, por duhet thënë se edhe kur ne i bëmë gjërat mirë, Danimarka na u përgjigj me një mbrojtje po aq cilësore", ka thënë Deschamps. "Për një kombëtare si e jona

dëmtimet nuk mund të jenë alibi. Lojtarët me të cilët përballuam këto dy ndeshje do të na nevojiten në të ardhmen, por Franca e Botërorit do të jetë një tjetër, sidomos nëse arrijmë t'i

rikuperojmë të gjithë. Idetë do të jenë më të qarta pas një muaji. Si për mua, por sidomos për djemtë, të cilët edhe një herë dhanë maksimumin", ka shtuar Deschamps.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ruzhdi Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike në Obiliq.

- Flora Xhuli nga Juniku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të gjimnazit "Edmond Hoxha" Junik.

- Masters BR-DOO. Shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 811935230.

- Blerim B. Bajrami B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit individual me emrin tregtarë D.P.Z. Auto Ngjyrosës "Buli" me nr. Unik 810934580.

- "Trend Shped" SH.P.K. shpall të pavlefshme Polica e sigurisë së kamionit TPL 0009532850 TPL PLUS 0002214215.

- Shield Recruitment&HR SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811277343

- Hana Nuha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të vitit I, II, III me nr: 1130 të vitit 2000, 1594 të vitit 2001 si dhe 2128 të vitit 2002 drejtimi Elektro Teknik "Naim Frashëri".

- Larta Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Njëmbëdhjetë të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Kolë Vokrraj nga Novosella e Epërme kk Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Kushtrim Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Rema Fazli Osmani Fushë Kosovë shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej".

- D.P.T "Beni" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Të biznesit 70488671.

- Jahë Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Diana Brovina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri".

- Saranda Preniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional "Prek Jakova" Prishtinë.

- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

